# DËSHMI ARKIVI

**A-442917**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Gjyqtarët s’mund ta prekin Thesarin”, Rama: Pagat e tyre do të ishin 3.8 herë më të larta se të mësuesve e mjekëve – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/hata-rama-gjykatesit-smund-ti-marrin-vete-parate-nga-thesari-i-shtetit/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 11:36:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 11:36:21 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | c39272e0373355afbe1215e78810b3f793885bb4c263b1624a8369c36fe3da11 |
| TEKSTI | 6b1caeda93be15e5ca8d22aed25028692ed92152a839abe272bba01a8f93a8bd |
| PAMJA | e5f4604a455d9f69b2b4d42ccfe8b2a14c3f78fa982fb6a638cb3d3b36f5b440 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | b5c8b283ec33773a63ce115e5275db5c5597655287e6cc0ae0ecf35e32c60e5b |
| E MËPARSHMJA | c27b06e0310dd2ffb5c5405c40112718ed8be478e2785be77113fae9c11c2dd8 |
| RRËNJA MERKLE | 0b6439cf09af002acf6ffba878872d12e4fabe601bb852ed9a98adac17b7c4e3 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b5c8b283ec33773a63ce115e5275db5c5597655287e6cc0ae0ecf35e32c60e5b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Edi Rama.

Duke iu referuar një deklarate të një gjykatësi se rritja e pagave të tyre janë aq para se GJKKO konfiskon nga krimi i organizuar, kreu i qeverisë shprehet se togat e zeza nuk e kanë të drejtën të bëjnë llogaritë e Thesarit të Shtetit.

*“Jo, kurrë nuk mund të flasë një gjykatës kështu! Historia e botës s’e ka parë që gjykatësit të thonë do t’i marrim paratë vetë nga thesari i shtetit se janë tonat dhe kjo “i kemi mbledhur vetë” është një hata më vete për nga shkalla rrëqethëse e padituresë mbi funksionimin e shtetit”, tha Rama.*

Madje bëri dhe krahasimin me institucione të tjera të cilat konfiskojnë para.

*“Le ta imagjinojmë sikur të çohen doganierët e tatimorët, policët e inspektorët dhe të thonë duam paratë që i kemi mbledhur vetë në thesarin e shtetit nga taksat e nga gjobat! Çfarë mbetet pastaj për mësuesit, mjekët, ushtarakët e plot e plot të tjerë që shërbejnë mijëra detyra të shtetit, për të cilat paguhen nga thesari”, tha kreu i qeverisë.*


duhej të kthehej sot, Alket Rizai…

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

Shefi i ekzekutivit u shpreh se edhe nëse pagat e togave të zeza, do të rriten në përqindjen që ata kanë kërkuar, atëherë një gjykatës do të marrë një pagë 3.8 herë më shumë se një mjek apo ushtarak.

“Dhe sikur kjo rritje e kërkuar pa ligj të pranohet si fakt i kryer, i bie që krahasimisht me mësuesin, mjekun, ushtarakun, një gjyqtar fillestar të marrë 3.8 herë më shumë ose një pagë 280% më të lartë. Të tjerët më lart nuk i merrni dot as me mend se sa më shumë”, shkruan kreu i qeverisë.

Më 26 gusht KLGJ dhe dy ditë më pas KLP e përcaktuan vetë pagën referencë të gjyqtarëve e prokurorëve, me një rritje të konsiderueshme, me argumentin se Kuvendi nuk kishte miratuar një formulë të re brenda 31 korrikut, edhe pse ishte i detyruar nga vendimi i Gjykatës Kushtetueses. Disa ditë më pas, Ministria e Financave bllokoi çdo transaksion nga thesari i shtetit për pagat e muajit gusht për pjesën dërrmuese të institucioneve të drejtësisë.

#Gjyqtare #paga #rama

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



LIVE POLITIKË

**PD: Hetim parlamentar për...**

Xhuljana Zhuleku · 2 minuta më parë



POLITIKË

**Debate në Komision për “Kayo”! PD: A...**

Xhuljana Zhuleku · 39 minuta më parë



POLITIKË

**Avokatët bojkotojnë procesin, shtyhet...**

Xhuljana Zhuleku · 4 orë më parë




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.